



Komuna e Preshevës shpall thirrjen publike për mbështetjen e grave sipërmarrëse përmes programit të granteve për startape.

Ky projekt financohet nga Ministria për Europë dhe Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë - Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Beograd.

THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJEN E GRAVE SIPËRMARRËSE PËRMES PROGRAMIT TË GRANTEVE PËR STARTAPE

Komuna e Preshevës shpall thirrjen publike për mbështetjen e grave sipërmarrëse përmes programit të granteve për startape.

Ky projekt financohet nga Ministria për Europë dhe Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë - Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Beograd.

Buxheti total i projektit: 9,600 euro

Numri i granteve: 4 (katër)

Fushat e mbështetjes:

- Rrobaqepësi
- Parukeri
- Punime dore
- Zeje të vjetra
- Kuzhinë tradicionale
- Teknologjia e Informacionit (IT)
- Ide të tjera inovative

Kush mund të aplikojë?

- Gratë e interesuara që synojnë të hapin një biznes të ri në sektorët e sipërpërmendur.
- Kandidatet duhet të jenë të përkushtuara për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e biznesit të tyre.

- Aplikantët duhet të regjistrojnë biznesin e tyre sipas ligjeve të Republikës së Serbisë **pas nënshkrimit të kontratës së grantit,ose**
- Aplikantët që kanë të regjistruar biznesin mbas 01/01/2025

Kriteret e vlerësimit:

Procesi i vlerësimit do të bazohet në kritere të qarta, duke përfshirë:

1. **Kontributi vetanak në financimin e projektit** – Aplikantët që marrin pjesë me fonde vetanake do të vlerësohen më lartë.
 - Nëse një aplikante merr pjesë me **10% të buxhetit të projektit**, ajo do të marrë **10 pikë**.
 - Vlerësimi për kontributin vetanak rritet deri në një maksimum prej **50% të buxhetit**, për të cilin aplikantja do të marrë **50 pikë**.
2. **Përdorimi i grantit** – Sipas rregullave të programit, **të paktën 70% e grantit duhet të përdoret për blerjen e pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme për biznesin**, ndërsa **30% mund të përdoret për shpenzime të tjera**, si qiraja, materialet për prodhim ose promovimi i biznesit.

Procesi i transferimit të mjeteve:

- **Pasi të përzgjidhet aplikantja dhe të nënshkruhet kontrata e grantit, biznesi duhet të regjistrohet në përputhje me ligjet në fuqi.**
- **Pas hapjes së xhirlogarisë së biznesit, mjetet financiare të grantit do të transferohen.**

Si të aplikoni?

Të interesuarat duhet të plotësojnë formularin e aplikimit dhe ta dorëzojnë brenda afatit të paraparë. Formularin mund ta gjeni pranë Komunës së Preshevës ose në uebfaqen zyrtare të Komunës.

Afati i fundit për aplikim: 30/04/2025

Për më shumë informacione, ju lutemi kontaktoni Komunën e Preshevës.

Zyra për zhvillim ekonomik lokal

Blerim Mehmeti – emaili: b.mehmeti@presevo.rs

Kryetar i Komisionit

Blerim Mehmeti





FORMULAR APLIKIMI PËR STARTAP TË GRUAS

1. Të dhënat personale:	
Emri dhe Mbiemri:	
Numri i telefonit:	
Email:	
Adresa e banimit:	
Numri personal:	

2. Informacione mbi biznesin:	
Emri i biznesit (nëse ka):	
Lloji i aktivitetit ekonomik (zgjedh një nga fushat e mbështetura):	

A keni eksperiencë paraprake në këtë fushë? (Po/Jo)

Nëse po, përshkruani shkurtimisht:

Përshkrim i shkurtër i idesë së biznesit:

Me sa mjete vetanake merrni pjesë në financimin e biznesit tuaj? (Rsd)

Mjetet vetanake	Mjetet e kërkuara	Komplet mjetet e investuara

Përshkrimi i shpenzimeve të planifikuara nga granti:

Lloji i shpenzimeve	Shuma - dinarë
Mjete pune (70% e mjeteve të investuara)	
Harxhime tjera	
Komplet mjetet e investuara:	

3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopje e dokumentit të identifikimit
- Dëshmi mbi bashkëfinancimin vetanak (nëse aplikohet)
- Profaktura e mjeteve të punës

4. Deklaratë personale:

Deklaroj se të dhënat e mësipërme janë të sakta dhe se do të respektoj të gjitha rregullat dhe procedurat ligjore për regjistrimin dhe funksionimin e biznesit tim sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Serbisë.

Data: _____

Nënshkrimi: _____